

FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E HËNË 11 PRILL 2022

Në fakt, do të flas për të njëjtin shqetësim që shprehu kolegu dhe patrioti im, Bujari, dhe dua shumë që fjalët e mia ta qetësonin sadopak atë, ashtu sikurse edhe një grup qytetarësh, që u mblohdën ditët e fundit në Vlorë, të shqetësuar për fatin e Sheshit të Flamurit, pikërisht për shkak të një thashetheme, që ky shesh do të shndërrohej në terminal autobusësh. Thashethemhapësve u duhej kjo për të ngacmuar ndërgjegjen qytetare, për të prekur shpirtin patriotik të vlonjatëve dhe për të ngjallur revoltën. Për ta bërë më të besueshme tablonë, në fakt, u ngjall edhe një debat mbi nostalgji, relikte dhe simbolika, që në pjesën më të madhe u përkisnin vetëm një moshe dhe u munduan ta mbanin gjallë këtë thashethem.

E vërteta është gjithmonë superiore dhe vjen një ditë kur duhet të përballesh me forcën e provës dhe të arsyes, e vërteta është që në Sheshin e Flamurit po punohet për t'i dhënë jetë atij sheshi dhe të gjithë zonës përreth. Vlora nuk mund të mbetet një qytet i tkurrur vetëm përgjatë bulevardit Vlorë-Skelë, prandaj vizioni i ri i dha jetë zonës historike, duke nxjerrë nga pluhuri dhe rrënojat çdo gur, që evokon qoftë një grimcë historie, e bashkë me jetën, biznesi ka filluar të lulëzojë edhe në këtë anë të harruar të qytetit të vjetër. Pikërisht tani, ky projekt madhështor ka mbërritur në zemër të Vlorës, në Sheshin e Flamurit. Si e gjeti ky projekt sheshin? Totalisht të harruar nga të gjitha qeveritë e mëparshme. Një zonë e zbratur nga arsyet për ta frekuentuar, e pushtuar përgjysmë nga një parking makinash e me një shatërvan plot llum e plehra, ku vetëm ujë nuk pikonte.

Ky projekt i vizionit të ri socialist mbërriti në këtë shesh për t'i kthyer atij dinjitetin dhe jetën vlonjate. Sepse deri tani vlonjatët pothuajse kanë munguar në jetën ekonomike dhe sociale të kësaj pjese të Vlorës, ndërsa dinjiteti i Sheshit kish humbur në disavantazhin e thellë që ekzistonte mes emocioneve artistike e historike të Monumentit të Shpalljes së Pavarësisë dhe standardeve të rëndomta të sheshit nën të. Unë besoj se çdo vlonjat që e ka parë sot projektin me sytë e zemrës, është dashuruar me të dhe mezi po pret ta shohë të jetësuar. Vlorës po i shkon rrjeti i kapilarëve ekonomikë në gjithë shtrirjen e saj. Vlora po merr përmasat që gjeografia i ka dhënë natyralisht. Jeta sociale ndjek jetën ekonomike, dhe të dyja bashkë pasurojnë njëra-tjetrën. Kjo po i ndodh edhe Sheshit të Flamurit.

Në 100-vjetorin e Pavarësisë, kur gjithë shqiptaria u derdh në Vlorë dhe u mikprit nga zemra e madhe sa një mal e vlonjateve dhe nga përpjekjet ekstreme të bashkisë së asaj kohe, të braktisur totalisht nga qeveria e po asaj kohe, të gjithë u skuqëm nga pamja e sheshit, kur na u desh t'i mbulonim me banerë reklamash e me sajesa të tjera gjitha gropat e shëmtitë që e kornizonin atë. Tani sheshi do të jetë pjesë e një koncepti të vetëm, që përfshin gjithë qytetin e që i jep çdo pjese të tij funksion dhe rol për qytetin e për qytetarin. Po nostalgjia? Dua të them dy fjalë edhe për nostalgjinë, sigurisht pa ngatërruar ngjyrat e nostalgjisë personale me vlerat reale historike. Nostalgjia i takon një brezi të caktuar dhe nuk mund të jetë po njësoj e rëndësishme për brezat e ardhshëm. Për këtë janë muzetë sipas profileve, për të konservuar nostalgjitë. Çdo brez ka nostalgjinë e tij, e cila nuk mund të na bëjë të mbajmë peng njëri-tjetrin, kur kjo do të thotë sakrifikim.

Nuk mundet që një qytet i tërë të privohet nga mundësitë për t'u zgjeruar e zhvilluar ekonomikisht, sepse kjo do të cenonte kujtimet e fëmijërisë apo të rinisë së vetëm një brezi. E përsëris: të vetëm një brezi. Kështu është edhe qyteti. Ai duhet të zhvillohet bashkë me shoqërinë dhe me ekonominë, madje duke i paraprirë këtij zhvillimi. Kështu po bëhet Vlora në të gjithë shtrirjen e saj, sepse është një qytet turistik, që mban në gjirin e vet pjesën muzeale, pa penguar jetën e re, e cila po shkon drejt dimensionit european. Dhe Vlora do të shkojë aty me vlerat historike rrokur fort nëpër deje, sepse historia nuk zhvendoset as nuk fshihet dot. Nostalgjia personale është mirë të futet aty ku e ka vendin: në sirtar. Përndryshe jeta nuk rrjedh. Po e mbyll me dy vargje të poetit Fernando Pessoa: "Nuk ka nostalgji më të dhimbshme/ Se ajo për gjërat që nuk kanë qenë kurrë." Faleminderit!